REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(KOMISIONI I BLERJEVE ME VLERE TE VOGEL)

Nr._____Prot **Krujë,më 09.10.2026**

PROCESVERBAL

(MBI HARTIMIN E ARGUMENTIMIN E PERDORIMIT TE KRITEREVE TE VECANTA TE KUALIFIKIMIT DHE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE PER PROCEDUREN PROKURIMIT BLERJE ME VLERE TE VOGEL

ME OBJEKT

''MOBILIM PER CERDHEN NR.1 TE QYTETIT KRUJE''

Në mbështetje të Neni 21/2 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" , neneve 2 dhe 56 te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" , Udhezimit nr. 5, datë 25.06.2021 te APP ''Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike'', **Urdheri nr 482. Date 17.09.2026 ''Për Krijimin e Komisionit të Blerjeve me Vlerë të Vogel ''**, sot me datë **09.10.2026** në Bashkinë Krujë , në zyren e Njesisë së Prokurimeve Publike në prani të anëtareve të Komisionit të Blerjeve me Vlere te Vogel, mbahet ky procesverbal me qëllim hartimin dhe argumentimin e kriterevet e vecanta te kualifikimit dhe specifikimeve teknike , per proceduren e prokurimit blerje me vlere te vogel me objekt, **''Mobilim per cerdhen nr.1 te Qytetit Kruje''** .

Nisur nga natyra dhe lloji i objektit te prokurimit i cili eshte lehtesisht i aksesueshem ne treg dhe ofrohet nga nje numer i pakufizuar subjekteve, KBV konkludon se per te percaktuar fituesin e kesaj procedure si kriter kualifikimi i vecante mjaftohet vetem me kushtezimin e paraqitjes dokumentacionit vijues:

- Vertetimin e administrates tatimore vendore per vitin 2026 ku subjekti ka seline sipas te dhenave te QKB se nuk rezulton debitor per periudhen e detyrimeve te maturuara korrente sipas kerkesave te ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar **.**

- **Argumentimi:**-Ky kriter ne kendveshtrimin e KBV eshte tregues i kapaciteteve financiare e juridike te subjektit ofertues ne permbushjen e kontrates objekt prokurimi, si dhe deshmon seriozitetin e tij ne raport me detyrimet tatimore perkatese. Kërkesa e

mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 , e LPP, si dhe nenit **40, pika 5 ,** nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

Ne keto kushte ky kriter duhet integrohet, ne ftesen perkatese per oferte bashkelidhur (sipas formularit nr 3 te udhezimit nr 5 date 25.06.2021 te APP),urdhrit te prokurimit.

- **Specifikimet Teknike** per proceduren respektive jane hartuar nga Drejtoria e Arsim Kulture dhe Sport , me shkresen **nr.____ Prot date ___.10.2026** , sipas parashikimeve te nenit 36 te Ligjit nr 162/2020 ''Per Prokurimin Publik ''.Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes respektive, si dhe normat perkatese te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore" .
- Specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat e mallit që prokurohet, duke e përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë sipas objektit të prokurimit, të cilat krijojnë kushte për konkurim të paanshëm dhe të hapur për të gjithë operatorët ekonomik, duke mundësuar një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët e interesuar. Këto specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që krijojnë mundësinë e konkurrencës dhe trajtim të barabartë nga marka të ndryshme të prodhimit të automjeteve për të gjithë Operatorët Ekonomikë e interesuar.
- Sa i perket standartit te tyre per cdo artikull ato jane hartuar duke marre ne konsiderate percaktimet respektive sipas artikujve dhe standartit te pranuar te tregut si dhe kerkesat perkatese te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".
- **Shenim:** Per cdo citim te nje specifikimi konkret apo standarti, ne karakteristika teknike te mesiperme ju veme ne dijeni se nga ana e AK do te konsiderohet i vlefshem edhe termi ***standart analog i pranuar sipas legjislacionit shqiptar ose ekuivalenti i tij/saj"*** i barazvleshem ne karakteristika , sipas kerkesave te nenit 36 te Ligjit 162/2020 ''Per prokurimin publik''.

- **Fondi limit** per proceduren me objekt, **''Mobilim per cerdhen nr.1 te Qytetit Kruje''** eshte hartuar nga grupi i punes i ngritur per te qellim duke iu referuar cmimeve te tregut per kategorin e mallrave/artikujve te ngjashem ,sipas referimeve dhe metodave te parashikuara ne nenin 76 te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" , i ndryshuar .
  Ky procesverbal mbahet ne 1 (nje) kopje , dhe administrohet ne dosjen e tenderit .

KOMISIONI I BLERJEVE ME VLERE TE VOGEL